# Kanosi me armë gjahu familjen e tij/ Arrestohet në flagrancë 79-vjeçari

Publikuar 13:05 - 17 Korrik, 2019
Nga **E.T**











Policia ka mundur të parandaloj një ngjarje e cila mund të kishte rezultuar fatale për një familje në Kukës.

Pas ndërhyrjes policore është arrestuar 79-vjeçari pasi akuzohet se ka ushtruar dhunë psikologjike

ndaj familjarëve dhe nipit të tijm duke i kërcënuar se do i vriste dhe armë dhe se do digjte shtëpinë.






Personi i arrestuar në flagrancë është shtetasi me inicialet I.S., 79 vjeç, banues në fshatin Kalimash, Kukës.



*Njoftimi i policisë*

Falë ndërhyrjes në kohë të Policisë parandalohet një ngjarje e rëndë brenda familjes.



Arrestohet në flagrancë 79 – vjeçari, i cili pas dhunës psikologjike të ushtruar ndaj familjarëve të tij dhe nipit, i ka kanosur me armë gjahu, si dhe të djegë shtëpinë me benzinë.

Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Kukës, arrestuan në flagrancë shtetasin I.S., 79 vjeç, banues në fshatin Kalimash.

## LAJMET E FUNDIT



POLITIKË / 19:28 - 26 Dhjetor, 2020

**PD kërkesë urgjente Ramës/ Bëj transparente çfarë negociatash ke bërë me palën greke?**



PREMIER LIGA / 19:27 - 26 Dhjetor, 2020

**VIDEO/ Fantastik Granit Xhaka, shqiptari i shënon supergol nga goditja e dënimit Çelsit**



SOCIALE / 19:17 - 26 Dhjetor, 2020

**Toka nuk gjen qetësi/ Regjistrohen lëkundje tërmeti në vend, ja epiqendra**



POLITIKË / 19:01 - 26 Dhjetor, 2020

**"Opozita "7×7=42" hesht!"/ Kulluri vë përballë fakteve Veliajn për rritjen e taksave**



SPORT / 18:56 - 26 Dhjetor, 2020

**LISTA/ "Vrasës" pranë portës, ish-sulmuesi i Kukësit në mesin e 10**

LEXO EDHE: Tiranë/ Arrestohen dy persona për vjedhjen e makinave luksoze

Kanosi ... Arresto


golashënuesëve më të mirë në botë për vitin 2020


SPORT / 18:34 - 26 Dhjetor, 2020
Jo vetëm Melo, një tjetër futbollist zhduket nga Partizani


POLITIKË / 18:33 - 26 Dhjetor, 2020
Vota e emigrantëve në zgjedhje/ KQZ kërkesë Gjendjes Civile: Sa është numri i shtetasve

AKTUALITET DENONCIM LIFE STYLE SPORT TEKNOLOGJI BOTA BLOG SATIRE POLITIKE VETINGU ENGLISH

Arrestimi i tij u bë pasi, në banesë, për motive të dobëta, ka shkatërruar orenditë e banesës, ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj familjarëve dhe fëmijët dhe më pas i ka kanosur me armë gjahu (çifte) si dhe ka tentuar të djegë shtëpinë me benzinë, por falë njoftimit në kohë të policisë dhe mbërritjes menjëherë në vendngjarje të inspektorit të Policisë së Zonës, i cili në bashkëpunim me familjarët i kanë marrë çiften dhe shishen e benzinës shtetasit I.S. duke e vënë në pranga.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e gjahut (çifte), disa fishekë, një shishe benzinë dhe një çakmak.

Materialet për veprime të mëtejshme i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprat penale "Dhuna në familje", "Kanosja" dhe "Shkatërrimi i pronës e mbetur në tentativë"./***CNA.al***